



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E QYTETIT  
KORÇË

RELACION  
PËR

MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË AKTIVEVE NGA BASHKIA KORÇË TEK UKKO SH.A.

Në zbatim të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen Administrativo-territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510 dt 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” të gjitha aktivitetet e Njësive Administrative ( ish komunat ) i janë transferuar Bashkisë Korçë. Sipas inventarizimit rezulton se një pjesë e këtyre aktiveve janë objekte ujësjellësa – kanalizime dhe materiale të tjera që lidhen me aktivitetin e tyre, për këto arsye propozojmë që këto aktive ti kalojnë UKKO sh.a. si shoqëria që ka kompetencë për menaxhimin e ujësjellës – kanalizimeve.

Në zbatim VKM nr. 63 datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura”, ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” me ndryshime, nenit 135/2/ë, nenit 168, nenit 169, të statusit të UKKO Sh.a. neni 10/2/ë, të Ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Udhëzimit nr. 30 dt 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kërkojmë nga ana e Këshillit Bashkiak të miratohet transferimi i aktiveve nga Bashkia Korçë tek UKKO sipas llogarive në tabelat bashkëngjitur:

Llogaria	202	-	4,988,830	lekë
Llogaria	212	-	1,367,801	lekë
Llogaria	213	-	21,769,193	lekë

Të ndara analitikisht sipas Njësive Administrative si më poshtë:

Njësia Administrative	Llogaria 202
DRENOVE	2,939,400
MOLLAJ	695,830
VOSKOPOJE	900,000
VITHKUQ	453,600
<b>TOTALI</b>	<b>4,988,830</b>

Njësia Administrative	Llogaria 212
DRENOVE	1,178,108
VOSKOPOJE	189,693
<b>TOTALI</b>	<b>1,367,801</b>

Njësia Administrative	Llogaria 213
DRENOVE	2,199,546
BULGAREC	989,970
MOLLAJ	17,457,557
LEKAS	1,122,120
<b>TOTALI</b>	<b>21,769,193</b>

Drejtorja Juridike  
Anxhela Dishnica



Drejtorja e Financës  
Valbona Ziko



KRYETARI I BASHKISË  
SOTIRAQ FILO

